



BASHKIA KORÇË

NR 4704/1 PROT
DATA 08/05/2026REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇËDREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKIMET
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. _____ Prot.

Korçë, më datë ___/___/2026

NJOFTIM**“SHPLLJE PËR PËRZGJEDHJEN E SHOQËRISË
QË DO TË NGARKOHET ME REZALIZIMIN E PROJEKTIT “STIMULIMI I
INDUSTRIVE KREATIVE”**

Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Korçë nr. 15, datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*” dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës” i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 63 datë 30.04.2026 konfirmuar mbi bazueshmërinë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 543/1 prot. datë 04.05.2026, Marrëveshjes nr. 1292 prot. datë 09.02.2026 midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë “Për financimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 377, datë 08.04.2026 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe përzgjedhjen e shoqërisë që do të zbatojë projektin “*Stimulimi i Industrive Kreative*” si dhe Vendimit të Kryetarit nr. 18 datë 05.05.2026 për shpalljen e së njëjtës procedurë “*Shpallje konkursi për përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e projektit Stimulimi i Industrive Kreative ne qytetin e Korçës*”; Bashkia Korçë njofton se të gjithë subjektet që janë të interesuara për realizimin e projektit “*Stimulim i Industrive Kreative*” duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik (shoqëria) i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (provuar me vendim gjykatë/dokument tjetër lëshuar sipas kërkesave të ligjit nga institucionet përkatëse);
- Të ketë përvojë të dokumentuar në zbatimin e projekteve për zhvillimin ekonomik lokal;
- Të krijojë mundësi për vetëpunësim dhe sipërmarrje të vogël;
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me artizanatin /zejtarine ose fusha të ngjashme;
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura; (vërtetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi. (vërtetim nga gjykata);
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë (çertifikatë e gjëndjes gjyqësore/ose e ngjashme)

KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

BASHKIA KORÇE

Subjekti duhet:

NR PROT
DATA / 20

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve artizanale (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë artizanale (diplomë, listpagesa. cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të projektit të **“Stimulimi i Industrive Kreative**, mënyrës si do asistojë dhe do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme lokale kombëtare dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut në fushën e artizanëve/zejtarëve;
- Të ketë minimum 5 vite eksperiencë në fushën e artizanatit/zejtarisë dhe prodhuesve kreative lokale.

KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatohet në ofrimin e këtij shërbimi);
- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte
- Aftësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë brenda **afatit 2 javor nga data e afishimit** dokumentacionin e kërkuar pranë **zyrës së Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zarf të mbyllur**. Vlerësimi i dokumentacionit do të bëhet në sallën e Mbledhjes, Kati i I, në dt 22.05.2026 në Bashkinë Korçë.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në numrin e telefonit [+35582243353]; në adresën e postës elektronike: info@bashkiakorçe.gov.al ose të vizitoni faqen zyrtare të Bashkisë Korçë.

Kjo shpallje do të afishohet në stendën e Bashkisë Korçë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Korçë.

U shpall sot në Stendat e Bashkisë Korçë dt. 08 / 05 / 2026.

Spektori i Mardhënieve me Publikun _____

KRYETARI

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

BASHKIA KORÇE
NR 4703/1 PROT
DATA 08.05.2026



DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKIMET
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. _____ Prot.

Korçë, më datë ___/___/2026

NJOFTIM

“SHPALLJE PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE TË KONKURRENTËVE PËR MARRJEN ME QERA TË AMBIENTEVE PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TË ARTIZANËVE DHE PRODHUESVE KREATIVE LOKALË PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “STIMULIM I INDUSTRIVE KREATIVE”

Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë nr. 15 datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit “Stimulimi i Industrive Kreative” dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 63 datë 30.04.2026 “Për ndryshimin e VKB nr. 15 datë 29.0.2026, konfirmuar për bazueshmërinë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresë nr. 543/1 prot. datë 04.05.2026, Marrëveshjes nr. 1292 prot. datë 09.02.2026 midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë “Për financimin e projektit “Stimulimi i Industrive Kreative”, dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 378, datë 08.04.2026 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave të konkurrentëve për marrjen me qira të ambienteve për zhvillimin e aktiviteteve të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokalë për realizimin e projektit “Stimulimi i industrive kreative”, Vendimit të Kryetarit nr. 17 datë 05.05.2026 për shpalljen e së njëjtës procedurë “Shpallje për vlerësimin e ofertave të konkurrentëve për marrjen me qira të ambienteve për zhvillimin e aktiviteteve të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokalë për realizimin e projektit “Stimulimi i industrive kreative” Bashkia Korçë njofton se të gjithë subjektet që janë të interesuara për ofrimin e ofertave duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

2.1 Përshkrimi i Ambienteve që do Marrin me Qira

- Numri i ambienteve: 8 (tetë);
- Sipërfaqja e ambienteve: Jo më pak se 10 m² për secilin ambient;
- Vendndodhja: Tek Pazari i Korçës;
- Përshkrimi: Hapësira të pamobiluara të dizajnuara për të përfshirë një mjedis zyre dhe një sallon pritjeje. Te pajisura me tualet.
- Vlera mujore e qirasë do të jetë jo më shumë se 300 lekë për m².

2.2 Qëllimi i Përdorimit

Ambientet që do të merren me qira do të përdoren për zhvillimin e aktivitetit të artizanëve dhe prodhuesve kreative lokalë për realizimin e projektit “Stimulimi i Industrive Kreative”.

2.3 Kriteret për Subjektet Ofertuese

Subjektet/personat fizikë ofertues duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Fotokopje të kartës së identitetit dhe/ose fotokopje të çertifikatës së regjistrimit si subjekt (Nipt-i);
- Oferta me vlerën e qirasë mujore të firmosur nga subjekti/personi fizik;
- Të paraqesin dokumentacionin e pronësisë për ambientet e ofruara. (Çertifikatë pronësie; kopje kartelesh dhe fragment harte treguese, të 3 (tre) muajve të fundit).
- Të ofrojnë një planimetri të ambientit të ofruar dhe/ose foto bashkangjitur;

2.4 Afatet dhe Kushtet e Qirasë

- Afati i Qirasë: Qiraja do të jetë për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
- Shuma e Qirasë: Shuma e qirasë do të përcaktohet në bazë të ofertave të paraqitura dhe në përputhje me vlerën e tregut.
- Kushtet e Përdorimit: Ambientet duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në projekt dhe të mirëmbahen sipas standardeve të përcaktuara nga Bashkia Korçë.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë brenda **afatit 2 javor nga data e afishimit** dokumentacionin e kërkuar pranë **zyrës së Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zarf të mbyllur**. Vlerësimi i dokumentacionit do të bëhet në sallën e Mbledhjes, Kati i I, në dt 22.05.2026 në Bashkinë Korçë.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në numrin e telefonit [+35582243353]; në adresën e postës elektronike: info@bashkiakorçe.gov.al ose të vizitoni faqen zyrtare të Bashkisë Korçë.

Kjo shpallje do të afishohet në stendën e Bashkisë Korçë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Korçë.

U shpall sot në Stendat e Bashkisë Korçë dt. 08 / 05 / 2026.

Spektori i Mardhënieve me Publikun _____

KRYETARI
Sotiraq Filo

